

	ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA
Njësia: Unit: Jednica:	Nr. Prot.: Prot. No.: <u>45/2022</u> Br. Prot.:
Nr. i faqeve: No. of pages: <u>-14-</u>	Data: Date: <u>27.12.2022</u> Datum:
Brr. stranice:	Prireditor:



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE

PËR

REVISTËN “MJEKU”

Prishtinë,

Dhjetor, 2022

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK), në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22, paragrin 1 me nën-paragrin 1.1 dhe në lidhje me Nenin 23 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenin 23, paragrin 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK, e miratuar në mbledhjen e rregullt të datës 15 Qershor 2021, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 27.12.2022, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR
REVISTËN “MJEKU”**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 42/2022 të Kuvendit të OMK-së, datë 27 dhjetor 2022)

Kapitulli I - Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen veprimtaria e redaksisë së revistës “MJEKU” (tutje: revistës) si dhe kriteret, procedurat e botimit dhe përbajtja e publikimeve të kësaj reviste (tutje: publikimet).

Qëllimi i revistës është informimi i vazhdueshëm i profesionistëve shëndetësore dhe qytetarëve për temat aktuale në shëndetësi.

Botues i revistës “Mjeku” është Oda e Mjekëve të Kosovës.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton përbërjen dhe fushëveprimin e redaksisë. Gjithashtu përcakton strukturën, përmbajtjen, procedurat e vlerësimit, korrektimit dhe mirëmbajtjes së publikimeve si dhe financimin e revistës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Termet dhe shkurtesat e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:
 - 1.1 **Oda (OMK)** - nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;
 - 1.2 **Redaksia** - nënkupton komisionin e angazhuar veçanërisht për redaktimin e revistës;
 - 1.3 **Kryeredaktori** - kryesuesi i redaksisë;
 - 1.4 **Autori** - nënkupton personin i cili shkruan temën (publikimin);
 - 1.5 **Numri** - nënkupton numrin e revistës sipas radhës së botimit;
 - 1.6 **Portreti** - nënkupton hapësirën e veçantë në revistë për të shkruar lidhur me biografinë e mjekut;
 - 1.7 **Koordinatori** - zyrtari i shërbimit profesional të Odës;
 - 1.8 **Dorëshkrimi** - nënkupton artikullin të cilin e dorëzon autorit tek redaksia e revistës;
 - 1.9 **Recensenti** - nënkupton profesionistin e angazhuar për vlerësimin e dorëshkrimeve;
 - 1.10 **Korrektimi** - nënkupton korrigjimin e dorëshkrimit të vet nga ana e autorit;
 - 1.11 **Gazetari** - nënkupton zyrtarin informativ të angazhuar nga redaksia për intervistikimin dhe çështje tjera lidhur me temat e caktuara të revistës;
 - 1.12 **Arkivi** - nënkupton hapësirën e Odës në të cilën ruhen numrat e revistës, qoftë fizike apo digitale;

- 1.13 **Hapësira promovuese** - nënkupton hapësirën e veçantë të revistës e cila do të shfrytëzohet për marketing apo reklamat e ndryshme.
 - 1.14 **Vëllimi** - i referohet numrit të viteve të publikimit të revistës në mënyrë kronologjike nga viti i parë i lansimit të revistës. P.sh. vëllimi 1 përfshin numrat e publikuar të revistës në vitin e parë të lansimit të revistës, e kështu me radhë.
 - 1.15 **Revista** - Revista “Mjeku”.
-
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Kapitulli II - Redaksia e revistës

Neni 4

Përbërja dhe funksionimi i redaksisë së revistës

1. Redaksia e Revistës “Mjeku” (*në vazhdim të tekstit Redaksia*) është komision vendimmarrës për revistën dhe funksionon në koordinim me Këshillin Drejtues të Odës.
2. Redaksia përbëhet prej 9 (nëntë) anëtarëve të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues, në përputhje me dispozitat e Statutit të Odës dhe akteve normative të Odës. Redaksia mund të kërkojë shtim të numrit të anëtarëve (deri në 2 persona) sipas nevojës.
3. Kryeredaktori zgjidhet nga radhët e anëtarëve të redaksisë.
4. Mandati i anëtarëve të redaksisë është 4 vjet, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër katërvjeçar.

5. Mungesa e paarsyetuar e anëtarit në 3 (tri) mbledhje me radhë të redaksisë, rezulton me zëvendësimin e tij/saj.
6. Anëtari i ri emërohet nga Këshilli Drejtues i Odës me propozim të redaksisë.
7. Takimet e redaksisë së revistës organizohen në përputhje me vendimin e Planit Financiar të Këshillit Drejtues të Odës.
8. Selia e redaksisë është në zyrat e Odës.

Neni 5

Ushtrimi i kompetencave të redaksisë

1. Redaksia i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1 Cakton strukturën dhe përbajtjen e revistës;
 - 1.2 Zbaton procedurat për botimet e numrave të revistës;
 - 1.3 Angazhohet vazhdueshëm në caktimin e temave të reja lidhur me shëndetësinë;
 - 1.4 Shqyrton dhe lejon publikimin e dorëshkrimeve në revistë;
 - 1.5 Refuzon dorëshkrimet me karakter politik, dezinformues, denigrues dhe diskriminues;
 - 1.6 Cakton punën e gazetarit të angazhuar për revistën;
 - 1.7 Angazhon sipas nevojës recensemë për fushat e caktuara të cilët nuk mbulohen nga anëtarët e redaksisë;
 - 1.8 Cakton kriteret lidhur me hapësirën promovuese konform irregullativës së AKPPM-së;
 - 1.9 Zbaton buxhetin e Odës;
 - 1.10 Kryen edhe funksione të tjera sipas nevojës bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme normative të Odës.

- Redaksia bashkëpunon dhe kontakton në mënyrë të vazhdueshme me organet e tjera të Odës, për çështjet që janë në interes të përgjithshëm të Odës.

Kapitulli III - Revista

Neni 6

Struktura dhe përmbajtja e Revistës

- Logo e Revistës është në formë rrethore dhe përbëhet nga dy rrathë ku ndërmjet tyre në mënyrë harkore shkruan Revista Mjeku dhe OMK. Në pjesën qendrore të logos është e vendosur shkronja M.
- Logoja e Revistës vendoset në këndin e sipërm majtas të ballinës kurse djathtas saj shkruan Revista MJEKU.
- Fonti i tekstit është “Brandon Grotesque”.
- Pjesët përbërëse të Revistës janë:
 - Aktualitete në OMK;
 - Temat bosht të numrit;
 - Këshilla mbi parimet e etikës dhe deontologjisë mjekësore dhe këshilla juridike;
 - Portreti i një mjeku - biografia;
 - Hapësira promovuese - marketingu.
- Redaksia ka të drejtë të refuzojë botimin e dorëshkrimeve të cilat i konsideron se janë plagjiat dhe/ apo kanë karakter diskriminues të llojit racor, gjinor, etnik e politik.
- Revista do të botohet në gjuhën shqipe duke mos përjashtuar edhe gjuhët tjera zyrtare, sipas nevojës.
- Para botimit të çdo numri të revistës, materiali duhet të lekturohet pas vlerësimit final të përmbajtjes nga redaksia.
- Redaksia e revistës ka të drejtë të vendos për plotësim/ndryshim të strukturës dhe përmbajtjes së revistës në përgjithësi.
- Revista ka publikim periodik.
- Llojet e artikujve të temës bosht që botahen në Revistë janë:
 - Prezantim rasti;

- 10.2. Editorial;
- 10.3. Letër për redaktorin;
- 10.4. Shënim teknik;
- 10.5. Rishikim dhe rishikim sistematik;
- 10.6. Meta analizë;
- 10.7. Artikull original.

Neni 7

Prezantim rasti dhe prezantim rastesh - Neni i ri

11. Prezantim rasti përfshin një deri pesë pacientë me ç' rast përshkruhet një sëmundje e pazakontë apo një shfaqje e pazakontë e sëmundjes dhe/apo trajtimit.
12. Prezantim rasti ofron informata për komunitetin profesional në lidhje me shfaqjen e sëmundjeve të pazakonta, manifestimet e pazakonta të sëmundjes dhe/apo trajtimit.
13. Prezantim rasti kufizohet në 1500 fjalë, 5 figura dhe/apo tabela dhe deri 10 referenca.
14. Prezantimi i një serie rastesh (*case series*) mund të përfshijë numër më të madh pacientësh, zakonisht deri njëzet.
15. Prezantim i një serie rastesh kufizohet në 2000 fjalë, nga 1 figurë dhe/apo tabelë për rast dhe 20 referenca.
16. Prezantimi i rastit / rasteve përbëhet nga:
 - 16.1. Titulli;
 - 16.2. Abstrakti;
 - 16.3. Hyrja;
 - 16.4. Prezantimi i rastit/rasteve;
 - 16.5. Diskutimi dhe përfundimet.

Neni 8

Editorial

1. Editoriali trajton në mënyrë të shkurtër një problematikë të caktuar, bazuar në vështrimet dhe gjetjet e studimeve të tjera.

2. Editoriali, gjithashtu, shërben për të térhequr vëmendjen ndaj ngjarjeve në kohët e fundit dhe për ndonjë risi apo tematikë me interes të përgjithshëm për lexuesit.
3. Editoriali ftohet nga redaktori apo shkruhet nga redaktori.
4. Editoriali kufizohet në 500 fjalë dhe deri 10 referenca.

Neni 9

Letër për redaktorin

1. Letër për redaktorin trajton çdo temë me interes për lexuesin e revistës duke përfshirë komentet për artikujt e botuar më parë.
2. Komentet duhet të janë objektive dhe konstruktive.
3. Letër për redaktorin mund të përdoret gjithashtu për të shprehur hipoteza të reja dhe për të térhequr vëmendjen e lexuesve ndaj çështjeve me interes për temën e caktuar të cilës i referohet.
4. Autori i artikullit të botuar më parë dhe i komentuar nga autori i letrës për redaktorin, zakonisht ftohet të jep një përgjigje me shkrim që definohet si *përgjigje ndaj letrës për redaktorin*.
5. Letër për redaktorin kufizohet në 300 fjalë, mund t'i ketë deri 2 figura dhe/ apo tabela dhe 5 referenca.

Neni 10

Shënimi teknik

1. Shënimi teknik, i njojur gjithashtu, edhe si *innovation teknik*, përshkruan një teknikë ose procedurë specifike, modifikim të një teknike ekzistuese ose pajisje të re që mund të zbatohet në mjekësi.
2. Shënimi teknik kufizohet në 2000 fjalë, mund t'i ketë deri 10 figura dhe/ apo tabela, 1 video (*vegëz online*) dhe deri 20 referenca.
3. Shënimi teknik përbëhet nga:
 - 3.1 Titulli;
 - 3.2 Hyrja;
 - 3.3 Metodat dhe rezultatet;
 - 3.4 Diskutimi dhe përfundimet

Neni 11

Rishikimi dhe rishikimi sistematik

1. Rishikimi është një vlerësim kritik i të dhënave shkencore nga studimet e mëparshme të lidhura me një temë të caktuar.
2. Ky tip artikulli kufizohet në 2000 fjalë dhe 5 figura dhe/apo tabela, kurse numri i referencave nuk është i kufizuar.
3. Rishikimi sistematik është analizë e detajuar e të gjitha punimeve në dispozicion të një problematike të caktuar.
4. Ky tip artikulli kufizohet në 3000 fjalë dhe 5 figura dhe/apo tabela kurse numri i referencave nuk është i kufizuar.
5. Rishikimi përbëhet nga:
 - 5.1 Titulli;
 - 5.2 Abstrakti;
 - 5.3 Hyrja;
 - 5.4 Metodat;
 - 5.5 Rezultatet;
 - 5.6 Diskutimi dhe përfundimet.
6. Rishikimi sistematik përbëhet nga:
 - 6.1 Titulli (*në titull duhet të figurojë fraza - rishikim sistematik*)
 - 6.2 Abstrakti;
 - 6.3 Hyrja;
 - 6.4 Metodat;
 - 6.5 Rezultatet;
 - 6.6 Diskutimi dhe përfundimet.

Neni 12

Meta analiza

1. Meta analiza është analizë statistikore e gjetjeve nga të paktën dy studime referente.

2. Qëllimi i një meta analize është të vlerësojë rezultatet e studimeve të caktuara duke analizuar, kahasuar dhe interpretuar gjetjet e tyre.
3. Në meta analizë duhet të analizohen kriteret e përfshirjes, madhësia e mostrës, karakteristikat e pjesëmarrësve në studim dhe rezultatet për secilin studim të përfshirë në meta analizë.
4. Për realizimin e meta analizës nuk kërkon leje nga komiteti etik, por të gjithë autorët inkurajohen të registrohen ne platformën online Prospero.
5. Meta analiza kufizohet në 5000 fjalë dhe 5 figura dhe/ apo tabela kurse numri i referencave nuk është i kufizuar.
6. Meta analiza përbëhet nga:
 - 6.1 Titulli (*në titull duhet të figura jë fraza - meta analizë*);
 - 6.2 Abstrakti;
 - 6.3 Hyrja;
 - 6.4 Metodat;
 - 6.5 Rezultatet;
 - 6.6 Diskutimi dhe përfundimet.

Neni 13

Artikulli origjinal

1. Artikulli origjinal është një përshkrim i detajuar i veprimtarisë kërkimore të shkruar nga hulumtuesit që kanë bërë studimin.
2. Studimi i artikullit origjinal duhet të sigurojë lejen nga Komisioni për Çështje Etike.
3. Në rast të dizajnjimit të studimeve klinike të randomizuara apo jo të randomizuara, përpas lejes nga Komisioni për Çështje Etike, regjistrimi i studimit në regjistër përkatës të studimeve klinike është i obligueshëm.
4. Artikulli origjinal kufizohet në 3000 fjalë dhe 5 figura dhe/ apo tabela dhe deri 50 referenca.
5. Artikulli origjinal përbëhet nga:
 - 5.1 Titulli;
 - 5.2 Abstrakti;

- 5.3 Hyrja;
- 5.4 Metodat;
- 5.5 Rezultatet;
- 5.6 Diskutimi dhe përfundimet.

Neni 14

E drejta për publikim

1. Çdo profesionist i fushave të ndryshme ka të drejtë të ofrojë temat për botim në revistë, me kusht që ato tema të janë me interes për shëndetësinë.
2. Redaksia e revistës përkrah temat të cilat përbajnë debate konstruktive të bazuara në fakte, njëkohësisht ka të drejtën të vendos lidhur me vlerësimin dhe publikimin e tyre.
3. Autori ka të drejtë të bëjë korrektimin e publikimit të tij/saj në rast të ndonjë lëshimi eventual, me lejen e redaksisë së revistës e cila vlerëson dhe aprovon të njëjtën. Kjo bëhet në një rubrikë të veçantë në numrin pasues të revistës ku shpjegohet detaji i korrektuar i artikullit (në versionin online).
4. Autori/autorët mbajnë përgjegjësinë për origjinalitetin e dorëshkrimit dhe vërtetësinë e fakteve.

Neni 15

Hapësira promovuese

1. Revista mund të përbajë edhe hapësira promovuese për kompanitë e interesuara.
2. Vendosja e përbajtjes promovuese dhe përqindja e hapësirës promovuese miratohet nga redaksia.

3. Ballina e revistës nuk është hapësirë reklamuese.
4. Çmimorja lidhur me hapësirën promovuese përcaktohet në harmoni me aktet normative të rregullores së veçantë për marketing në OMK.

Neni 16

Shërbimi profesional i Revistës

1. Redaksia e revistës gjatë ushtrimit të veprimtarisë do të ketë në dispozicion koordinatorin nga shërbimi profesional i Odës si dhe gazetarin e saj.
2. Koordinatori i revistës nga radhët e shërbimit profesional të Odës caktohet nga Këshilli Drejtues. I njëjti duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me redaksinë dhe të shpreh gatishmëri për çdo planifikim të organizimit të takimeve apo komunikimit mes tyre, si dhe të respektojë çdo detyrë e cila i jepet nga redaksia.
3. Koordinatori i revistës ka për detyrë të përpilojë procesverbalet e mbledhjeve të redaksisë duke ruajtur konfidencialitetin e diskutimeve dhe debateve në mbledhje.
4. Gazetari zgjidhet me konkurs sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli Drejtues.
5. Gazetari i redaksisë ka për detyrë respektimin e detyrave të dhëna nga redaksia të cilat përfshijnë punën në teren apo brenda zyrave të Odës.

Neni 17

Arkiva

1. Revista do të ketë arkivin e saj fizik dhe digjital brenda zyrave të Odës.

2. Përgjegjës për arkivin e revistës do të jetë koordinatori i caktuar nga radhët e shërbimit profesional të Odës.

Neni 18

Buxheti

1. Revista botohet nga buxheti i OMK-së si dhe fondet e saj që burojnë nga pjesa promovuese, donacionet e ofruara nga donator vendor dhe të huaj.
 2. Të hyrat e fituara nga marketingu do të derdhen në xhirollogarinë e Odës, të cilat do të destinohen për funksionimin e mëtutjeshëm të revistës.

Neni 19

Mbikëqyrja e punës së Revistës

1. Redaksia e revistës për punën e saj i përgjigjet Këshillit Drejtues të Odës.
 2. Redaksia ka për detyrë që të raportojë tek Këshilli Drejtues për çdo botim të numrit të revistës.
 3. Raporti i punës së Revistës duhet të dorëzohet tek Këshilli Drejtues jo më larg se 30 (tridhjetë) ditë nga botimi i numrit të revistës.

Kapitulli IV - Dispozitat përfundimtare

Neni 20

Hyrja në fuqi

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Redaksia.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK dhe nënshkrimit të saj nga Kryetari i OMK.
3. Çdo çështje e parregulluar në këtë rregullore për funksionimin e revistës, redaksia ka të drejtë ta propozojë për miratim në Këshillin Drejtues të Odës, deri në plotësim-ndryshimin e së njëjtës në Kuvend.

Prishtinë, 27.12.2022

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Sci

